

Dashnor Kokonozi

BIBLIOTEKA

85H-32

K 81


FAMILJA  
E  
SHENJTE

*Tregime*

854-32  
K 81

DASHNOR KOKONOZI

**FAMILJA**  
**E**  
**SHENJTË**



Tregime

SHTEPJA BOTUESE ONUFRI  
1995

# Përmbajtja

	Faqe
Përmbajtja .....	3
Hakmarrja e djallit .....	5
Familja e shenjtë .....	18
Infarkti i tretë .....	29
Ashensori .....	38
Letra të panjohura të Lirikës .....	42
Perëndim dielli .....	54
Ëndrrat ikin në mëngjes .....	59

## HAKMARRJA E DJALLIT

-Djalli, djalli! Shikojeni djallin! Ka nxjerrë kokën te shkallët. - Vajza e vogël ulërinte me sa kishte në mushkëri, duke parë midis gishtave, me të cilët kishte mbuluar fytyrën për t'u dukur sa më e llahtaritur. I ati kthen sytë nga ajo dhe priti që të heshte.

-Po kape djallin , mor babi, mos e lërë të ikë!

Luigji shtypi me nervozizëm cigaren në tavllë.

-Nuk ka ku të shkojë, - tha nëpër dhëmbë, - këtu do të kthehet.

Vajza bërtiti edhe njëherë tjetër. E kishte parë përsëri të vëllanë të nxirrte kokën te fundi i shkallëve.

-Hëngri bukë? - pyeti Kristimën.

-Nuk guxoi të vinte, kushedi ç'do të dëgjojmë sot për të.

-E çfarë ka mbetur tjetër për të dëgjuar. nuk je ngopur me kaq?

Ai pati një farë ndryshimi në ton. Kristina u kthye të shihte të shoqin në sy. I kishte ndodhur edhe herë të tjera. që kur ajo ishte në kulmin e zemërimit, ai, për çudi, zbutej.

I shoqi lëshoi me inat filxhanin e kafesë mbi syprinën e tryezës dhe u ngrit.

-Dëgjo. Luigj - i kërceu më keq asaj, mua nuk më mbajnë më nervat, sa të të duroj edhe ty. Unë s'jam më e zonja, në s'je edhe ti, kape dhe çoje në shkollë të vagabondëve. Nuk do të rrojmë më me frikë. A më dëgjon, apo jo, merre çoje ku të duash!

Ai iu afrua dritares. Kur u qetësua disi, ndjeu të bijën që kishte hipur mbi një karrige dhe po e tërhiqte nga jaka e pulovrës, duke u përpjekur t'i ngjitej mbi supe.

-Babi, nuk do e qëllosh në kokë? - e pyeti ajo, duke ia afruar buzët te veshët.

I ati i ngriti një cullufe flokësh dhe e uli në dysheme. Vajza rrudhi buzët dhe iu kacavar pas rripit të mesit.

-Hiqini këta filxhanë këtej, - tha duke iu shmangur syve të së shoqes. - Vini pak rregull! Po vjen Petroja.

Ajo shfryu.

-Me shumë kujdes i zgjedh edhe ky torollak oraret e vizitave.

-Nuk ha merakun njeri të bëjë vizita tani, - foli ai me zë gjithnjë e më të butë. - Ashtu kemi një punë.

Atje poshtë, duke ecur anash gardhit të ulët, që veçonte një parcelë të vogël lulishteje, Petros iu duk se i kapi veshi disa fjalë të çuditshme. Nuk pati dyshim se aty, në gëmushën prej shermasheku, që fshehur një grup fëmijësh. Veshi i zuri diçka që po e bënte të qeshte, por u përmbajt vetëm ngaqë nuk deshë t'u tërhiqte vëmendjen atyre që po flisnin.

-Mondi, ty të mos mbetet hatri, unë me këto veshë e kam dëgjuar nga babai të thotë se berberet janë kurva.

-Mondi, se mos të mbetet hatri ty, ë? - ndërhyri një zë tjetër. - Kur thuhet, për shembull se të gjitha janë ashtu, kjo nuk do të thotë se janë tamam të gjitha. Për shembull, nëna jote nuk është.

-Ua, e dini çfarë, - foli një zë i tretë, - këto mendime janë të këqia. Më mirë ta hedhim në votë.

-Mirë. Një... Asnjë tjetër. E sheh, Mondi? Askush tjetër nuk ta pranon për nënë.

-Po ju provojeni njëherë. Ajo mua nuk më rreh kurrë.

-Duhet parë për ndonjë tjetër, që të na pëlqejë të gjithëve. Bledi, ta hedhim njëherë në votë atë nënën tënde?

-Unë dua të shpëtoj për vete nga ajo. Babai thotë se ajo është hysterike.

Petroja lëvizi. Zërin e fëmijës që foli së fundi e njohu. Megjithatë nuk pati kohë të mendonte më gjatë, sepse njëri prej tyre bërtiti:

-Po hysterike ç'do të thotë?

-Ta shpjegoj herë tjetër.

-Po ti, Genti, di gjë?

-Unë di vetëm të them që të mos lëvizim prej këtej pa gjetur një nënë të mirë për të gjithë.

Petroja ndjeu një si ngërç nën muskulin e nofullës dhe goja i mbeti hapur krejt si pas një mekjeje. Midis fëmijëve ishte, dhe s'kishte pse të dyshonte, edhe djali i shefit të tij.

-Fjala "hysterike" ka lindur para çlirimit dhe përgjithësisht u ngjiten atyre grave që duan të tregojnë historira kur hanë bukë... -zuri të shpjegonte njëri, i cili nga fundi e uli zërin tepër. Me sa dukej nuk ishte shumë i sigurtë në ato që thoshte. - Nesër do t'ju jap përgjigje.

Luigjit nuk i ra në sy vështrimi që Petroja hidhte

vjedhurazi nga Kristina. ndërsa vetë ajo ishte krejt e huaj për punët e të shoqit. Lëkura e tendosur dhe pakëz e skuqur e fytyrës së saj, nuk i kishte bërë kurrë përshtypje më parë Petros.

-Pse nuk e ndez cigaren? - pyeti Luigji kur ai pushoi së foluri.

-Do të ma ketë nxjerrë mamaja nga xhepi shkrepshen.

- tha ai si i zënë në befasi.

Luigji kontrolloi nëpër xhepa dhe pastaj iu afrua një sirtari nga ku nxorri një çakmak. I ndezi cigaren dhe pastaj ia la në dorë.

-Ta kam falur, - i tha duke i rënë supëve.

Petroja la gotën e rakisë mbi tryezë dhe e rrotulloi çakmakun nëpër duar duke qeshur. E falenderoi dhe e shkrepsh di sa herë, pa mundur ta ndizte.

-Qenka i vjetër, - tha pak i trishtuar.

-Epo kalit që falet nuk i shihen dhëmbët.

-Si, si? - ai nisi të gajasej. - Hej dreq, nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë. Kalit që falet nuk i shihen dhëmbët. Hihih!

Vajza e vogël u vërsul e trembur t'i tregonte së ëmës gojën e çapëlyer të mysafirrit.

-Ku e keni Bledarin? - pyeti papritur Petroja.

-Djallin! - thirri me krenari vajza e vogël.

-Këtej do të jetë, - ndërhyri me një buzëqeshje të shtirë Kristina. - Shko e thirre! - iu drejtua së bijës. - mjaft brodhi jashtë.

Vajza thartoi turinjte dhe iu kacavar së ëmës në qafë.

Petroja u ngrit të ikte. Hej dreq o punë, tha si me vete duke zbritur shkallët. Kalit që falet nuk i shihen dhëmbët.

-Mos u llasto ashtu. - i foli Kristina së bijës. - shko

atje ku të thashë.

Kristina, ndjeu përsëri atë inatin që i përvëlonte fytyrën sa herë binte fjala për të birin. Po nuk ka qenë kështu ai, djall me brirë, përsëriste pa pushim.

Gjithçka kishte filluar nja tri javë më parë, edhe pse sjellje të çuditshme tek i biri kishte vënë re prej kohësh. Ajo nuk mund t'i besonte logjikës së atyre grave që, duke qenë të paafta të mbanin nën kontroll fëmijët, flisnin për një lloj tolerance që ka nevojë moshë. Si mund ta toleronin Bledin atë ditë kur e nisën të bliinte bukë dhe ai humbi gjithë ditën rrugëve. Ata kishin qenë të detyruar të dilnin të gjithë ta kërkonin.

-Ja tek është përbindëshi! - kishte folur nëpër dhëmbë Luigji, kur e kishte parë me shportën në dorë, duke biseduar krejt i pamerakosur me dy vajza me grykëse të zeza në trotuarin përballë. Ata kishin mbetur pa gjak në fytyrë. Kurrë nuk e kishin ndjerë veten më të fyer.

Kapërcyen rrugën të tre, po Kristina dhe vajza nuk iu afruan atij.

-Qëlloje fort, babi! - thirri vajza nga pas Luigjit.

-Hesht, ti! - e qortoi ajo. - E di vetë ai.

Në darkë Luigji i tha se atë çast kishte dashur ta qëllonte me pëllëmbë syve, po më zor i kishte ardhur nga vajza se nga i biri. Ishte mjaftuar duke e pështyrë në surrat.

Të paktën vajza tani e kuptonte më së miri. Më parë ajo i mbante lotët në majë syve po ta prekte kush Bledin. Në një nga ato ditë Kristina i kishte thënë se atë e rihnin ngaqë e donin dhe bënë çmos për ta futur në rrugë të mbarë. Dhe, për çudi, vajza që prej asaj dite i ulërinte të vëllait duke qenë e bindur se ajo ishte një mënyrë e re e të shprehurit të dashurisë.

Sapo doli nga shkolla, Bledi pa dikë që po i buzëqeshte së largu. U shkëput nga shokët dhe nisi të ecte



drejt mikut të babait të tij, Petros. Ishte i vetmi që nuk e shihte si të qe një lebroz. Sidoqoftë atë çast atij iu desh ta prekte nga mënga e xhaketës, se Petroja, me sa dukej, po i buzëqeshte ndonjë tjetri. që mbase ishte tutje. përpara.

-Bledi, Bledi! - i foli ai pak si i trembur dhe, kur hapi dhëmbët e verdhë dhe qeshi me të vërtetë, Bledit iu desh të mendonte se mbase deri atë çast ai po qeshite me veten. Petroja as vetë nuk po e dinte si ishin sjellë punët që ato ditë po e takonte gjithnjë e me shpesh djalin e mikut të vet. Dy ditë më parë ishte çuditur së tepërmi kur Bledi i kishte thënë se babai ishte inatosur shumë se kishte gjetur një fotografi të tijën në çantën e Kristinës. Ai ishte menduar gjatë dhe i kishte thënë se ishte e pamundur që një fotografi e tij të kishte rënë në dorë të Kristinës, madje as të vetë Luigjit. Bledi kishte këmbëngulur se mund të qe fjala për ndonjë fotografi ku mund të kishte dalë me babanë, pastaj ajo do ta kishte prerë me gërshërë.

E tërhoqi nga krahu djalin dhe e futi në një ëmbëltore aty afër.

-Dje i bënë me çokollatë këto akullore. - tha Bledi duke e rumbullakosur me gjuhë.

Petroja sikur u hutua dhe pa me vëmendje akulloren e vet. Pastaj u kthye nga ai.

-Kalit që të falim nuk është mirë t'i shikosh dhëmbët, - ai ia dha përsëri të qeshurës me "hihihhi" të rrufeshme.

-Xhaxhi Petro, a janë të këqija gratë hysterike? - e pyeti papritur Bledi.

-Pse, cila është hysterike? - pyeti duke e parë djalin në sy.

-Pyeta kot.

-S'duhet të jenë të këqija, bile nuk janë të këqija fare.

-Mamaja është hysterike.

-Ashtu? Kush e tha këtë? - Ai doli menjëherë në

trotuar dhe atje tutje i bëri me shenjë djalit të afrohej. -Ti e dëgjove vetë se unë që më përpara thashë se nuk janë të këqija.

-Babai nuk thotë kështu. Kot edhe ai. Vetëm se mamaja e përmendi emrin tënd në gjumë.

Petroja u zbeh i tëri dhe pa me shqetësim rrotull, si ai njeriu që kërkon një shteg për t'ua mbathur këmbëve. Njëmijë pyetje iu kërleshën në grykë, duke i dhënë atë ndjesinë e njeriut që po mbytet.

-Dalim, - tha Kristina pasi u pa fshehurazi për herë të fundit në pasqyrë. Petroja u ngrit menjëherë, i shtrëngoi fort dorën Bledit dhe doli te shkallët. Kristina u kthye edhe një çast në kuzhinë. Bledi sapo ishte ulur në tryezë dhe po bënte detyrat.

-Dëgjo, - nisi ajo t'i jepte porositë e fundit, - në shtëpi të mos futësh asnjë njeri. Po gjeta rrëmujë kur të vij, do të thotë se nuk ke mësuar fare dhe do të të ngre në mes të natës dhe të të pyes mësimet. Derën nuk po ta mbyll me çelës se do të vijë tezja të sjellë vajzën. Edhe zjarrin mos e ndiz se do të na i vesh flakën shtëpisë.

Ajo përplasi derën pas vetes, por kur iu afrua Petros, që po priste jashtë, u përpoq ta fshihte tronditjen e asaj pasditeje të çuditshme. I shoqi e kishte lajmëruar që në mëngjes se atë ditë do të organizonin një mbrëmje argëtimi, por andej nga dreka, kur ajo po linte punën për t'u kthyer në shtëpi, ai e kishte marrë në telefon për t'i thënë se diçka e ngutshme nuk e lejonte të kthehej në shtëpi, kështu që në darkë do të takoheshin te restoranti i hotel "Drinit". Nga ora gjashtë e darkës ai kishte porositur Petron të vente e ta merrte në shtëpi. Deri këtu nuk kishte asgjë të keqe, nuk ishte hera e parë që ai i kalonte pasditet në punë. Diçka tjetër ia prishi humorin. Petroja, sikur të mos kishte biseduar